VENDIM
Nr. 198, datë 3.8.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 181, DATË 13.7.2022, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'NRG POWER' SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/6 prot., datë 27.7.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 13.7.2022 'Mbi licencimin e shoqërisë 'NRG Power' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike"',

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 181, datë 13.07.2022, vendosi të licencojë shoqërinë "NRG Power" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- Shoqëria kishte detyrimin që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitonte në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674/4 prot., datë 18..2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar.
- Me depozitimin e dokumentacionit të kërkuar, duhet shfuqizuar pika 2 dhe pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 181/2022.
- Në nenin 113 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 181, datë 13.7.2022 "Mbi licencimin e shoqërisë 'NRG Power' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike".
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti